Financuar nga Bashkimi Evropian

Instituti për të drejtat e njeriut

UNDP

Zëri i të rinjve

Rekomandime për promovimin e dialogut ndëretnik dhe krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse



Titulli:
Zëri i të rinjve: Rekomandime për promovimin e dialogut ndëretnik dhe krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse

Botues:
Instituti për të Drejtat e Njeriut

Rreth botuesit:
Margarita Caca Nikollovska

Redaktor:
Maria Çekrexhi

Autor:
Fjolla Zllatku Ajrulla

Lektura:
Tatjana Stojanovska

Dizajni grafik:
Damjan Kanzurov

Përktheu:
Vjosa Taipi

Nëntor 2024, Shkup

Ky publikim është realizuar me ndihmën e projektit "Mbështetja e BE-së për ndërtimin e besimit në Ballkanin Perëndimor" i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit për të Drejtat e Njeriut dhe nuk pasqyron gjithmonë pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe UNDP-së.

PËRMBAJTJE

HYRJE 4

AKTIVIZMI RINOR PËR SHOQËRI INKLUZIVE 5

ROLI I TË RINJVE NË ZHVILLIMIN E DIALOGUT MULTIETNIK 6

Vështrime dhe sugjerimet e nxënësve 8

AKTIVIZMI RINOR PËRMES KREATIVITETIT 9

BASHKËPUNIMI ME SHKOLLAT 11

SFIDAT DHE ZGJIDHJET E IDENTIFIKUARA TË PROPOZUARA NGA NXËNËSIT 12

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME 14

HYRJE

Përfshirja etnike në shkollat maqedonase paraqet një sfidë kryesore për dekada dhe është e lidhur thellë me dinamikën më të gjerë politike dhe sociale në vend. Maqedonia e Veriut është shtëpia e një popullsie multietnike, me maqedonasit dhe shqiptarët që janë dy komunitetet më të mëdha etnike, së bashku me komunitetet më të vogla të turqve, romëve, serbëve, boshnjakëve, vllahëve dhe të tjerëve. Megjithëse ky diversitet pasuron strukturën kulturore të vendit, ai është gjithashtu një burim tensioni, veçanërisht në sistemin arsimor, ku segregimi sipas gjuhës dhe etnisë është dukuri e zakonshme.

Rrënjët e ndarjes etnike në shkolla mund të gjenden në tensionet historike midis komunitetit maqedonas dhe shqiptar, veçanërisht gjatë konflikteve të fillimit të viteve 2000. Këto tensione kanë çuar në një sistem arsimor të fragmentuar, me procese arsimore paralele për nxënësit nga komunitete të ndryshme etnike. Në shumë shkolla në të gjithë vendin, nxënësit maqedonas dhe shqiptarë janë të ndarë në klasa të ndryshme, ose mësojnë në ndërrime të ndryshme, apo edhe në objekte të ndryshme, siç është rasti në Kumanovë. Si rezultat, ata rrallë komunikojnë, gjë që përforcon ndarjet që shpesh vazhdojnë në moshën e rritur.

Kjo ndarje ndikon jo vetëm në arsim, por edhe në zhvillimin social të nxënësve. Hulumtimet e kryera nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës[1] dhe USAID-i[2] tregojnë se nxënësit që janë të ndarë sipas përkatësisë etnike shpesh rriten me kuptim dhe respekt të kufizuar për kulturat e tjera, gjë që mund të përkeqësojë tensionet etnike në shoqërinë e gjerë. Mungesa e mundësive për ndërveprim kuptimplotë gjatë viteve të shkollës lë pak hapësirë për zhvillimin e miqësive midis nxënësve nga komunitete të ndryshme etnike, gjë që rezulton në stereotipe dhe paragjykime të forcuara.

Struktura e programit mësimor gjithashtu kontribuon në këtë ndarje. Në shumë raste, ka pak përputhje në lëndët ose aktivitetet që u ofrohen nxënësve nga komunitete të ndryshme etnike, duke e bërë të vështirë mësimin së bashku. Aktivitetet jashtë mësimore, të cilat mund të shërbejnë si një platformë për komunikim ndërkulturor, shpesh nuk përdoren shumë, duke lënë pak mundësi që nxënësit të shoqërohen jashtë komunitetit të tyre etnik.

Përfshirja etnike në shkollat maqedonase është jetike për zhvillimin e respektit të ndërsjellë dhe shkëmbimin e vlerave kulturore. Të rinjtë luajnë një rol kryesor në këtë proces, pasi ata janë brezi që mund të kapërcejë ndarjet etnike dhe të kontribuojë në krijimin e një shoqërie harmonike.

Në këtë drejtim, Instituti për të Drejtat e Njeriut zbatoi projektin “Aktivizmi i të Rinjve për Shoqëri Gjithëpërfshirëse”, i cili zbatohet në kuadër të projektit “Mbështetja e BE-së për Ndërtimin e Besimit në Ballkanin Perëndimor”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Qëllimi kryesor i projektit është të promovojë gjithëpërfshirjen përmes aktivizmit rinor, me fokus të veçantë në nxitjen e dialogut ndëretnik midis nxënësve nga komunitete të ndryshme etnike në shkollat e mesme në Maqedoninë e Veriut.

Bazuar në aktivitetet e zbatuara të projektit, u përgatit ky raport, i titulluar "Zëri i të rinjve: Rekomandime për promovimin e dialogut ndëretnik dhe krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse", i cili ofron një pasqyrë të situatës në arsimin tonë nga këndvështrimi i nxënësve, dhe ofron konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e dialogut ndëretnik dhe theksimin e rolit të të rinjve në këtë proces. Qëllimi i këtij raporti është t'u japë zë të rinjve duke shndërruar pikëpamjet dhe rekomandimet e tyre në një dokument publik që do t'u dërgohet palëve të interesuara përkatëse dhe publikut të gjerë.

1 https://rm.coe.int/sixth-ecri-report-on-north-macedonia/1680ac8c47

2 https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00ZN51.pdf

AKTIVIZMI RINOR PËR SHOQËRI INKLUZIVE

Projekti "Aktivizmi rinor për shoqëri gjithëpërfshirëse" i Institutit për të Drejtat e Njeriut u zbatua në periudhën nga dhjetori 2023 deri në nëntor 2024. Qëllimi i projektit ishte ngritja e vetëdijes dhe angazhimi i të rinjve në zhvillimin e dialogut për promovimin e një shoqërie multietnike për të gjithë. Ky qëllim u arrit duke përfshirë nxënësit në zhvillimin e dialogut multietnik dhe ngritjen e vetëdijes për respektimin dhe avancimin e tipareve të ndryshme të identitetit të komuniteteve, me qëllim krijimin e një shoqërie multietnike.

Në kuadër të projektit u realizuan këto aktivitete:

- Organizimi i katër tribunave me temën “arsimi gjithëpërfshirës” me nxënësit e shkollave të mesme nga Shkupi, Tetova dhe Kumanova, në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase, shqip dhe turqisht.
- Mbajtja e tre punëtorive, në formatin e një mbrëmjeje filmike, për nxënësit e shkollave të mesme nga Shkupi, Tetova dhe Kumanova, me qëllim të krijimit të një mjedisi joformal për shoqërim, shkëmbim të ideve dhe frymëzim për krijimin e ndryshimeve pozitive në shkollë dhe shoqëri.
- Zhvillimi i një konkursi artistik me temën "Aktivizmi rinor përmes krijimtarisë" dhe një konkurs fotografie me temën "Kultura ime përmes objektivit", me qëllim të inkurajimit të shprehjes kreative (fotografisë dhe vizatimit) të të rinjve, si një lloj aktivizmi rinor, njohja me tiparet kulturore të komuniteteve të ndryshme etnike dhe promovimi i ideve dhe rekomandimeve të tyre për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.
- Përgatitja e teksteve të shkurtra për një blog nga nxënësit e shkollave të mesme, me temë: "krijimi i një shoqërie multietnike, kultivimi dhe promovimi i multikulturalizmit".

Këto aktivitete kontribuan në inicimin e një debati publik mbi krijimin e një dialogu multietnik midis nxënësve, rritjen e mirëkuptimit dhe angazhimit të të rinjve, si dhe njohjen me komunitetet e tjera etnike dhe mbledhjen e njohurive për njohjen e ndërsjellë dhe integrimin multietnik brenda dhe jashtë procesit arsimor. Gjegjësisht, aktivitetet kontribuan në njohjen më të mirë të situatës dhe në krijimin e një tabloje më të plotë për arsim multietnik dhe ndikimit të tij tek të rinjtë.

Ky raport u përgatit në bazë të diskutimeve të mbajtura në tribuna dhe punëtori, të cilat u zhvilluan në katër shkolla të mesme nga Shkupi, Tetova dhe Kumanova, ku mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase, shqip dhe turqisht, si më poshtë:

- ShMQSh "Dimitar Vllahov" – Shkup;
- SHMMQSH „Dr. Pançe Karagjozov "- Shkup;
- SHMK “Pero Nakov” – Kumanovë; dhe
- SHMKM "Nikolla Shtejn" – Tetovë.

Tabela 1 – Të dhënat për nxënësit në katër shkollat e përzgjedhura[3]

	ShMQSh "Dimitar Vllahov"	SHMMQSH „Dr. Pançe Karagjozov"	SHMKM "Nikolla Shtejn"	SHMK "Pero Nakov"
Qyteti	Shkup	Shkup	Tetovë	Kumanovë
Numri i përgjithshëm i nxënësve	491	2419	2218	819
Meshkuj	249	619	961	379
Femër	242	1800	1257	440
	Numri i përgjithshëm i nxënësve për gjuhë mësimi			
Maqedonisht	253	1418	351	522
Shqip	225	1001	1801	279
Gjuha turke	13	-	66	-

Qëllimi i këtij raporti është të theksojë rolin dhe t'u japë zë të rinjve në procesin e krijimit të arsimit dhe shoqërisë gjithëpërfshirëse. Raporti përmbledh pikëpamjet, komentet, sfidat dhe rekomandimet për përmirësimin e dialogut ndëretnik në vend.

ROLI I TË RINJVE NË ZHVILLIMIN E DIALOGUT MULTIETNIK

Në kuadër të projektit "Aktivizmi rinor për shoqëri inkluzive", në shkollat e mesme u organizuan katër tribuna, në tri qytete multietnike: Shkup, Tetovë dhe Kumanovë. Këto shkolla janë të njohura për strukturën e tyre të larmishme etnike dhe nxënësit vijnë nga komunitete të ndryshme etnike si maqedonas, shqiptarë, turq, romë dhe të tjerë.

Tribunat u organizuan në ShMQSh "Dimitar Vllahov" – Shkup, në SHMMQSH "Pançe Karagjozov" – Shkup, në SHMKM "Nikolla Shtajn" – Tetovë dhe në SHMK "Pero Nakov" – Kumanovë. Tribunat ishin të hapura për të gjithë nxënësit nga shkollat e përzgjedhura dhe u mbajtën në ambientet e shkollave. Në këto tribuna, u diskutuan avantazhet dhe sfidat e arsimit në një mjedis multietnik. Qëllimi ishte t'u jepej të rinjve një shans për të shprehur mendimin e tyre dhe për të bërë sugjerimet e tyre për krijimin e një arsimi jo vetëm gjithëpërfshirës, por edhe për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Qëllimi kryesor i tribunave ishte të krijonte hapësirë për diskutim të hapur në të cilin nxënësit do të kishin mundësi të ndanin mendimet dhe përvojat e tyre. Tribunat u drejtuan nga lehtësues që vinin nga dy bashkësi etnike, përkatësisht një maqedonase dhe një shqiptare, gjë që siguroi që diskutimet të ishin gjithëpërfshirëse dhe që të pasqyrohej


3 Të dhënat në këtë tabelë janë marrë nga faqja e internetit e Komunës së Kumanovës me kërkesë për qasje të lirë në informatat me karakter publik në qytetin e Shkupit dhe komunën e Tetovës.

përbërja multietnike e bashkësive. Fasilitatorët luajtën një rol kryesor në udhëheqjen e diskutimeve, duke bërë pyetje që inkurajuan reflektimin mbi rëndësinë e gjithëpërfshirjes, tolerancës ndëretnike dhe bashkëpunimit midis nxënësve. Për më tepër, në tribunat ishin të pranishëm përkthyes në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke, me qëllim që tu mundësohet nxënësve që nuk flasin rrjedhshëm gjuhën maqedonase të marrin pjesë plotësisht në bisedime. Një mbështetje e tillë gjuhësore ishte e një rëndësie të veçantë për krijimin e një atmosfere gjithëpërfshirëse dhe sigurimin e qasjes së barabartë për të gjithë pjesëmarrësit.

Secila nga katër tribunat filloi me sqarim dhe mendim kritik rreth asaj se çfarë do të thotë termi "përfshirje/inkluzion". U organizuan ushtrime, të cilat synonin të inkurajonin nxënësit të përqendroheshin në gjërat e përbashkëta që i bashkojnë ata, në vend të dallimeve që i ndajnë. Në këtë mënyrë, përmes aktiviteteve interaktive, nxënësit u inkurajuan të ndajnë përvojat dhe vlerat, duke promovuar kështu mirëkuptimin e ndërsjellë dhe krijimin e një ndjenje të përbashkët të përkatësisë, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike ose kulturore.









Nxënësit patën mundësi të flasin për përvojat e tyre personale në mjedisin shkollor, duke përfshirë sfidat me të cilat përballen për shkak të ndarjeve etnike dhe gjuhësore, dhe u inkurajuan të propozojnë ide dhe zgjidhje për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e krijimit të shkollave dhe shoqërisë gjithëpërfshirëse. Shumë prej tyre theksuan rëndësinë e prezantimit të aktiviteteve dhe orëve të përbashkëta, të cilat ata mendonin se do të inkurajonin shoqërimin dhe punën së bashku midis nxënësve nga paralele dhe gjuhë të ndryshme mësimore.

Një nga objektivat kryesore të tribunave ishte promovimi i ideve dhe zgjidhjeve që do të rrisin pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e krijimit të shkollave dhe shoqërisë gjithëpërfshirëse. Përmes këtyre tribunave të hapura dhe interaktive, të rinjtë patën mundësinë të angazhohen në procesin e identifikimit të problemeve, por edhe të japin idetë e tyre se si të tejkalohen sfidat dhe të përmirësohet arsimi multietnik në shkolla. Nxënësit patën mundësi të flasin për përvojat e tyre në mjedisin shkollor, duke përfshirë sfidat me të cilat përballen për shkak të ndarjes etnike dhe gjuhësore. Përveç kësaj, nxënësit diskutuan se si pengesat etnike ndikojnë në përvojat e tyre në shkollë dhe sugjeruan aktivitete të përbashkëta që mund të jenë një zgjidhje për të kapërcyer segregacionin.

Tribunat gjithashtu kanë për qëllim të inkurajojnë mendimin kritik midis të rinjve për përkatësinë etnike, qëndrimet e tyre ndaj diversitetit dhe rolin e tyre në krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse. Gjatë diskutimeve, nxënësit ndanë përvojat e tyre për jetën shkollore, duke përfshirë sfidat me të cilat përballen për shkak të ndarjes gjuhësore dhe etnike në shkolla. Shumë nxënës thanë se nuk kanë shumë shpesh mundësi për aktivitete të përbashkëta me nxënës nga bashkësi të tjera etnike, prandaj ata propozuan iniciativa dhe aktivitete të ndryshme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e situatës.

Vështrime dhe sugjerimet e nxënësve:

- Më shpesh të mbahen aktivitete, siç ishin tribunat, të cilat do tu mundësojnë të kenë kontakt më të madh me bashkëmoshatarët që mësojnë në një gjuhë tjetër mësimore, ose që janë anëtarë të një grupi tjetër etnik, gjë që do të ndihmojë në çrrënjosjen e stereotipeve dhe paragjykimeve të ndërsjella. Për më tepër, nxënësit theksuan rëndësinë e mbledhjeve të rregullta dhe ngjarjeve javore që nxisin dialogun dhe ndërveprimin midis grupeve të ndryshme etnike.
- Të organizohen më shumë ekskursione të përbashkëta ku nxënësit të kenë mundësi të afrohen më shumë me njëri-tjetrin. Nxënësit theksuan se në të kaluarën janë zhvilluar ekskursione të përbashkëta që kanë ndikuar pozitivisht në përfshirjen dhe njohjen e ndërsjellë midis nxënësve.
- Të organizohen aktivitete jashtëshkollore si: panaire, punëtori krijuese ose sport, në të cilat gjuha nuk do të jetë pengesë, sepse komunikimi do të bazohet në shprehjen e lirë. Gjithashtu, futja e aktiviteteve jashtëshkollore më bashkëpunuese, si projekte sportive ose kërkimore shkencore, mund të ndihmojë në tejkalimin e hendekut etnik. Këto interesa të përbashkëta ofrojnë një terren neutral për ndërtimin e miqësive dhe mirëkuptimit.
- Të ridizajnohet organizimi i ndërrimeve në mënyrë që të përzihen nxënësit që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe shqipe në mënyrë më të barabartë, duke zvogëluar potencialisht ndarjen etnike.

- Megjithëse tribunat u mbajtën në shkolla ku mësimi zhvillohet në disa gjuhë, nxënësit vunë re se ata mësojnë në ndërrime të ndryshme, në kate të ndryshme ose në ndërtesa krejtësisht të ndryshme. Nxënësit gjithashtu sugjerojnë që stafi i shkollës të përmirësojë kapacitetin dhe aftësitë e tyre për përballje me provokimet dhe problemet e mundshme midis fëmijëve, pasi vendimi për ndarje të nxënësve, inicialisht mund të shkaktojë tensione dhe provokime.
- Të parashihet lëndë zgjedhore që do tu mundësojë nxënësve të mësojnë gjuhën e komuniteteve të tjera etnike. Kjo mund të nxisë komunikim dhe mirëkuptim të përmirësuar. Nëse fillimisht ka pak interes për këtë, promovimi i këtyre orëve mësimore si thelbësore për kompetencën kulturore mund të rrisë numrin e nxënësve të interesuar.
- Tribunat të zhvilluara nga pjesëmarrësit u vlerësuan si të suksesshme dhe shprehën interes të madh për përfshirje më të madhe në aktivitete të ngjashme në të ardhmen. Kjo sugjeron nevojën për mbështetje të vazhdueshme për iniciativa të tilla që u mundësojnë të rinjve të luajnë një rol aktiv në ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

AKTIVIZMI RINOR PËRMES KREATIVITETIT

Në kuadër të këtij projekti, u organizuan tre punëtori për shkollat e mesme të përzgjedhura, me qëllim të inkurajimit të nxënësve nga bashkësi të ndryshme etnike për të krijuar vepra kreative që pasqyrojnë veçoritë kulturore dhe gjuhësore të bashkësive të tyre. Një punëtori u organizua gjithashtu në Shkup, një në Kumanovë dhe një në Tetovë. Në punëtori, u projektua filmi *Freedom writers* (Shkrimtarët e lirisë), dhe pas shfaqjes, nxënësit kishin mundësi të angazhohen në diskutim të hapur. Këto punëtori u konceptuan si një qasje inovative ndaj shkëmbimit kulturor, ku nxënësit, përmes mediave kreative, mund të theksojnë veçantinë e komuniteteve të tyre, dhe në të njëjtën kohë të mësojnë për kulturën e bashkëmoshatarëve të tyre nga grupe të ndryshme etnike.

Para mbajtjes së punëtorive, u shpall një konkurs publik përmes të cilit nxënësit mund të merrnin pjesë me veprat e tyre krijuese, të cilat në një farë mënyre përfaqësojnë traditën kulturore dhe gjuhësore të bashkësisë së tyre etnike. Pjesëmarrësit u inkurajuan të përdorin forma të ndryshme të shprehjes artistike.

Për shumëkënd, kjo ishte hera e parë që merrnin pjesë në këtë lloj aktiviteti, që u dha mundësi për të nxjerrë në pah individualitetin e tyre dhe për të prezantuar kulturën e tyre para një grupi më të madh. Punimet artistike të nxënësve u ekspozuan në punëtoritë.

Punëtoritë filluan me shfaqjen e filmit *Freedom Writers (Shkrimtarët e Lirisë)*, me qëllim të inkurajimit të mendimit kritik në mesin e nxënësve. Nxënësit e pëlqyen shumë filmin dhe i inkurajoi të debatojnë dhe të diskutojnë ide të dobishme. Pas shfaqjes, u mbajt një votim për të zgjedhur veprat më të mira artistike nga pjesëmarrësit në konkurs, ku fituesi, si një çmim, fitoi kufje.





Freedom Writers (Shkrimtarët e Lirisë) është një film frymëzues që tregon histori të vërtetë të një mësueseje që motivon nxënësit e saj nga komunitete të ndryshme etnike për të kapërcyer paragjykimet dhe vështirësitë e jetës përmes shkrimit. Filmi tregon se si, me empati dhe edukim, mund të arrihet mirëkuptimi dhe respekti i ndërsjellë midis kulturave të ndryshme. Ai kryesisht arriti të përcjellë mesazhe të rëndësishme në lidhje me diversitetin në një shoqëri multietnike, duke nxitur respektin për kulturën e bashkëmoshatarëve dhe mendimin kritik rreth shfaqjes së multikulturalizmit.







Filmi përshkruan situata në të cilat personazhet duhet të kapërcejnë paragjykimet dhe stereotipet e tyre në mënyrë që të bashkëpunojnë dhe të respektojnë njëri-tjetrin. Kjo krijoi një bazë që nxënësit të reflektojnë mbi paragjykimet e tyre dhe se si sjellja e tyre mund të formësohet nga dallimet kulturore dhe etnike. Duke treguar momente të tilla të ndërveprimit kulturor, filmi përgatiti nxënësit për një diskutim rreth jetës së tyre të përditshme dhe marrëdhënieve ndëretnike në mjedisin e tyre shkollor.

Pas përfundimit të shfaqjes filmike, nxënësit u inkurajuan të marrin pjesë në një diskutim të udhëhequr nga fasilitatorët, të cilët i udhëzuan nxënësit të reflektojnë mbi rolin e shkëmbimit kulturor në forcimin e gjithëpërfshirjes dhe bashkëpunimit midis komuniteteve etnike. Fasilitatorët kishin për detyrë të krijonin një mjedis të sigurt për nxënësit për të shprehur mendimet, pikëpamjet dhe ndjenjat e tyre mbi tema që lidhen me gjithëpërfshirjen dhe shkëmbimin kulturor. Diskutimi ishte aq i strukturuar sa secili nxënës kishte mundësi të ndajë përshtypjet e tij për filmin, por edhe të nxirrte një paralele midis asaj që pa në film dhe asaj që përjetoi në shkollën e vet. Nxënësit folën për përvojat e tyre në mjediset ku ndarja etnike është e dukshme dhe si ndikon në aftësinë e tyre për të komunikuar dhe bashkëpunuar me nxënësit nga komunitetet e tjera.

Një nga temat kryesore të diskutimit ishte gjetja dhe kultivimi i gjërave që janë të përbashkëta dhe të cilat i bashkojnë ata (si në rastin e nxënësve nga filmi ishte arsimi, librat, njohuritë dhe përpjekjet e përbashkëta për të realizuar një projekt) dhe se si ato mund të ndihmojnë në kapërcimin e stereotipeve dhe paragjykimeve që ekzistojnë midis komuniteteve të ndryshme. Si rezultat, u propozuan ide të reja për aktivitete të mëtejshme që do të vazhdojnë këtë shkëmbim, duke përfshirë organizimin e ekspozitave të përbashkëta, garave në art dhe kulturë, dhe iniciativa të përbashkëta për të promovuar përfshirjen gjuhësore dhe kulturore.

Këto punëtori treguan se përmes krijimtarisë dhe shkëmbimit kulturor, nxënësit mund të ndërtojnë një ndjenjë më të madhe të bashkësisë dhe gjithëpërfshirjes. Përfaqësimi i vlerave të tyre kulturore jo vetëm që i bashkoi nxënësit nga komunitete të ndryshme etnike, por gjithashtu krijoi mundësi të reja për bashkëpunim dhe respekt. Në këtë mënyrë, filmi nuk ishte vetëm një mjet argëtimi, por u përdor si një mjet i fuqishëm për të edukuar dhe inkurajuar nxënësit të mendojnë për rolin e tyre në krijimin e një atmosfere gjithëpërfshirëse shkollore dhe shoqërore.

BASHKËPUNIMI ME SHKOLLAT

Sfida më e madhe në zbatimin e aktiviteteve të projektit ishte vendosja e bashkëpunimit të mirë me shkollat. Para sëgjithash, sfida e parë ishte njëfarë rezistence në shkolla të caktuara ndaj temës së projektit. Gjegjësisht, në disa shkolla mendonin se biseda me nxënësit për sfidat dhe përfitimet e të mësuarit dhe të jetuarit në një shoqëri multietnike mund të shkaktonte vetëm probleme dhe tensione.

Sfida e dytë me të cilën u përballëm ishte përfshirja relativisht e vogël e nxënësve që mësojnë në gjuhën shqipe ose turke në aktivitetet e projektit. Gjatë komunikimit me shkollën, u theksua rëndësia e pranisë së nxënësve të etnive të ndryshme në aktivitetet e projektit, në mënyrë që të ketë një diskutim produktiv dhe kuptimplotë. Megjithatë, ishte vërtet sfiduese të sigurohej prania e tyre. Sipas përfaqësuesve të shkollave, disa nga arsyet pse ka pasur pak ose shumë pak përfshirje të nxënësve të etnisë shqiptare, turke ose rome është për shkak se nuk ka interes te këta nxënës për këtë lloj aktiviteti ose për ndonjë aktivitet që lidhet me shkollën. Në raste të caktuara, kur bisedonim me nxënësit dhe mësuesit e tjerë në shkolla, mësuam se ka shpërndarje joadekuate të informacionit brenda shkollave. Gjithashtu, në disa shkolla, stafi mësimor dhe shërbimi profesional kanë kontakt vetëm me nxënësit e etnisë së tyre. Kjo e bën edhe më të vështirë shpërndarjen e informacionit midis nxënësve. Është shqetësuese që në disa shkolla edhe stafi mësimor dhe shërbimi profesional i etnive të ndryshme kanë kontakt shumë të kufizuar me njëri-tjetrin.

Sfida e tretë me të cilën u përballëm në zbatimin e aktiviteteve të projektit ishte qëndrimi i disa shkollave që nxënësit nuk kanë interes ose motivim për të marrë pjesë në ndonjë aktivitet brenda ose jashtë shkollës. Ky qëndrim i disa prej stafit të shkollës çon në kushtin që të përfshihen vetëm disa nxënës “të përzgjedhur”, të cilët besojnë se do të ishin të interesuar për ngjarje dhe aktivitete të tilla, gjë që rezulton që disa nxënës të mbingarkohen me aktivitete shtesë, ndërsa të tjerë nuk kanë mundësi të përfshihen, sepse nuk marrin informacionin e duhur. Sipas informacionit që morëm, në raste të caktuara gjërat shkojnë aq larg sa nxënësit që janë të përfshirë në aktivitete të caktuara nuk u jepet një zgjedhje nëse duan të marrin pjesë ose jo, por detyrohen të marrin pjesë, dhe në raste të caktuara ata madje marrin kërcënime se do të marrin të mungesa të pa paarsyeshme nëse nuk marrin pjesë në aktivitete.

Besojmë se sfida të tilla krijojnë mjedise në të cilat tensionet etnike ngufaten dhe ndarjet dhe paragjykimet thellohen, dhe përveç kësaj, mjedise në të cilat të rinjtë ndjejnë se nuk kanë zë dhe se mendimi i tyre nuk ka rëndësi. Përveç të rinjve, roli i mësimdhënësve dhe shërbimit profesional është thelbësor për të promovuar një mjedis tolerant dhe gjithëpërfshirës. Ky ishte edhe një nga përfundimet që dolën nga diskutimet në tribunat dhe punëtoritë. Në pyetjen: 'Kush mendoni se mund të krijojë më shumë inkluzion në shkollë?', përgjigjja më e zakonshme e nxënësve ishte: 'kujdestari i klasës, stafi mësimdhënës, drejtori apo vetë nxënësit'.

SFIDAT DHE ZGJIDHJET E IDENTIFIKUARA TË PROPOZUARA NGA NXËNËSIT

Përmes diskutimeve në tribunat dhe punëtoritë, nxënësit adresuan disa sfida kryesore që ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e tyre për t'u angazhuar në aktivitete gjithëpërfshirëse dhe për të zhvilluar një ndjenjë të unitetit me nxënës nga komunitete të ndryshme etnike. Këto sfida pasqyrojnë probleme të thella strukturore në sistemin arsimor dhe në shoqërinë në tërësi, të cilat bazohen në ndarjen etnike, barrierat gjuhësore dhe mungesën e aktiviteteve të përbashkëta. Nxënësit gjithashtu propozuan zgjidhje konkrete për tejkalimin e këtyre problemeve.



Një nga sfidat më të rëndësishme të identifikuara nga nxënësit është ndarja fizike midis nxënësve nga komunitete të ndryshme etnike. Në shumë shkolla në Maqedoninë e Veriut, nxënësit nga komunitete të ndryshme etnike shpesh mësojnë në paralele të ndara, në ndërrime të ndryshme, ndjekin mësimin në klasa që janë në kate të ndryshme, ose mësojnë në ndërtesa krejtësisht të ndryshme, në një skaj tjetër të qytetit, që do të thotë se rrallë kanë mundësi të takohen dhe të bashkëpunojnë. Kjo ndarje fizike jo vetëm që pengon shoqërimin ndëretnik, por gjithashtu krijon një pengesë psikologjike që nxit ndjenjat e distancës dhe mosbesimit midis nxënësve.

Nxënësit propozuan disa zgjidhje për të kapërcyer këtë sfidë, **një nga sugjerimet kryesore ishte riorganizimi i orarit mësimor të ndërrimeve për të përzier në mënyrë më të barabartë nxënësit që mësojnë gjuhë të ndryshme mësimore, duke zvogëluar potencialisht ndarjen etnike.** Për më tepër, ata besojnë se është e nevojshme **të rriten aktivitetet e përbashkëta si një mënyrë për të kapërcyer barrierat fizike dhe mendore.** Nxënësit sugjeruan që shkollat duhet të organizojnë më shumë aktivitete të përbashkëta mësimore që do të lejonin ndërveprim dhe punë të përbashkët. Këto aktivitete do tu mundësonin nxënësve të zhvillonin një ndjenjë më të madhe të bashkimit dhe besimit, duke zvogëluar kështu segregacionin.



Nxënësit gjithashtu si problem të madh theksuan mungesën e aktiviteteve të përbashkëta jashtëshkollore që kufizojnë njohjen dhe bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë. Aktivitetet jashtëshkollore janë një pjesë e rëndësishme e përvojës së shkollës, ku nxënësit mund të njihen me njëri-tjetrin, të bashkëpunojnë dhe të ndërtojnë miqësi

jashtë mësimit formal. Megjithatë, për shkak të natyrës së ndarë të shkollave, këto aktivitete shpesh organizohen posaçërisht për grupe të ndryshme etnike, duke humbur kështu mundësitë për ndërveprim të përbashkët.

Një nga sugjerimet më të rëndësishme nga nxënësit ishte rritja e numrit të aktiviteteve të përbashkëta jashtë mësimore, me theks në aktivitetet që do të jenë tërheqëse për nxënësit nga të gjitha komunitetet etnike. Garat sportive u përmendën si një shembull i një aktiviteti të përbashkët të suksesshëm, në të cilin nxënësit e etnive të ndryshme do të mund të bashkëpunonin. Nxënësit theksuan se sporti krijon kushte për punë ekipore dhe për një qëllim të përbashkët, i cili kontribuon në zvogëlimin e paragjykimeve dhe forcimin e besimit të ndërsjellë. Ata propozuan që shkollat të organizojnë më shumë gara sportive dhe turne që do të përfshinin ekipe të përziera nga grupe të ndryshme etnike.

Përveç sportit, nxënësit sugjeruan organizimin e ekskursioneve të përbashkëta dhe ngjarjeve kulturore, të tilla si koncerte, punëtori arti dhe shfaqje teatrore, në të cilat mund të merrnin pjesë nxënës nga komunitete të ndryshme. Këto aktivitete do tu mundësonin nxënësve të ndanin vlerat e tyre kulturore dhe gjuhësore, të cilat do të inkurajonin shkëmbimin kulturor dhe rritjen e gjithëpërfshirjes në shkolla.

Pengesa gjuhësore → "Nëse do të kishim lëndë zgjedhore gjuhë turke/shqipe/maqedonase, do të mësonim gjuhën"

Një nga sfidat më të mëdha për nxënësit ishte pengesa gjuhësore. Mos njohja e gjuhës së bashkësisë tjetër etnike krijon një pengesë të rëndësishme për komunikimin dhe bashkëpunimin midis nxënësve të etnive të ndryshme. Nxënësit maqedonas dhe shqiptarë shpesh nuk flasin gjuhën e njëri-tjetrit, gjë që i pengon ata të përfshihen në biseda ose aktivitete më të thella që kërkojnë komunikim. Kjo pengesë gjuhësore thellon ndjenjën e distancës dhe çon në shfaqjen e stereotipeve dhe paragjykimeve.

Nxënësit propozuan disa zgjidhje për të kapërcyer pengesën gjuhësore. Një nga sugjerimet më të zakonshme ishte **vendosja e lëndëve zgjedhore, ku nxënësit do të kenë mundësi të mësojnë gjuhën e komuniteteve të tjera etnike.** Kjo do të mundësonte që nxënësit të përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore dhe të zhvillojnë vetëdije dhe mirëkuptim më të madh kulturor. Gjithashtu u propozua që të organizohen klube joformale gjuhësore në të cilat nxënësit mund të mësojnë nga njëri-tjetri përmes komunikimit joformal dhe socializimit.

Për më tepër, **nxënësit sugjeruan prezantimin e aktiviteteve dhe projekteve që do të përfshijnë komunikim shumëgjuhësh**, siç janë prezantimet e përbashkëta ose projektet në grup për tema të ndryshme, ku nxënësit do të duhet të komunikojnë në gjuhën maqedonase, shqipe ose gjuhë të tjera. Kjo do të ndihmonte në rritjen e aftësive gjuhësore dhe tejkalimin e stereotipeve për mosnjohjen e gjuhës së të tjerëve.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Projekti "Aktivizmi rinor për shoqëri inkluzive" tregoi qartë se **të rinjtë në Maqedoninë e Veriut janë të gatshëm dhe të motivuar për të luajtur një rol aktiv në krijimin e një shoqërie inkluzive dhe harmonike.** Përmes pjesëmarrjes së tyre në tribunat dhe punëtoritë, ata treguan iniciativë dhe interes për të kapërcyer ndarjet etnike ekzistuese dhe për të ndërtuar një identitet të përbashkët të bazuar në respekt të ndërsjellë dhe shkëmbim kulturor. Megjithatë, përkundër këtij entuziazmi, projekti gjithashtu theksoi sfidat kryesore strukturore që duhet të tejkalohen në mënyrë që këto përpjekje të jenë të suksesshme në planin afatgjatë.

Pengesa gjuhësore u identifikua si një nga pengesat më të rëndësishme për përfshirjen në shkolla. Nxënësit shpesh ndjekin shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhë të ndryshme, gjë që kontribuon në ndarjet midis grupeve etnike, pasi ata rrallë kanë mundësi për mësim dhe bashkëpunim të përbashkët. Në këtë kontekst, mos njohja e gjuhës së bashkësisë tjetër etnike ka provuar të jetë një pengesë serioze për komunikimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

Ndarja fizike, si organizimi i mësimit në ndërrime të ndryshme apo në ambiente të veçanta shkollore, e komplikon më tej këtë problem. Nxënësit në shumë raste nuk kanë mundësi të takohen, të bashkëpunojnë ose të ndërtojnë miqësi me bashkëmoshatarë nga bashkësi të tjera etnike. Kjo situatë krijon një ndjenjë të distancës dhe shkëputjes, e cila inkurajon stereotipet dhe paragjykimet dhe jep mundësinë që të ketë pasoja afatgjata në marrëdhëniet ndëretnike në shoqëri.

Për të kapërcyer këto sfida, është thelbësore të vendosen masa shtesë që do të inkurajojnë përzierjen e nxënësve dhe do të krijojnë më shumë mundësi për aktivitete të përbashkëta. Rritja e numrit të aktiviteteve të përbashkëta jashtëshkollore, të tilla si garat sportive, ngjarjet kulturore dhe projektet krijuese, mund të luajnë një rol kryesor në promovimin e besimit dhe respektit të ndërsjellë. Këto aktivitete u mundësojnë nxënësve të njihen me njëri-tjetrin, të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë përvoja të përbashkëta që do t'i bashkojnë në dallimet etnike.

Për më tepër, barrierat gjuhësore duhet të kapërcehen përmes programeve për shkëmbim gjuhësor dhe vendosjes së lëndëve zgjedhore në të cilat nxënësit mund të mësojnë gjuhën e bashkësisë tjetër etnike. Kjo jo vetëm që do të përmirësojë aftësitë e komunikimit të nxënësve, por gjithashtu do të rrisë ndërgjegjësimin e tyre kulturor dhe do të inkurajojë një qasje më të hapur ndaj diversitetit.

Gjithashtu, **roli i shkollave dhe stafit mësimdhënës është thelbësor në nxitjen e gjithëpërfshirjes. Mësimdhënësit dhe drejtorët duhet të ofrojnë mbështetje për aktivitete të tilla, për të krijuar një klimë shkollore në të cilën të gjithë nxënësit, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, do të ndjehen të pranuar dhe të vlerësuar.** Përfshirja e mësimdhënësve në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, si dhe trajnimi i tyre në metoda gjithëpërfshirëse të punës, mund të përmirësojë ndjeshëm dialogun ndëretnik dhe të forcojë gjithëpërfshirjen në shkolla. Është me rëndësi të veçantë që stafi mësimdhënës dhe profesional në shkolla të sensibilizohet për rëndësinë e multikulturalizmit dhe të zhvillojë kompetenca demokratike midis nxënësve, si toleranca, empatia, hapja ndaj kulturave të tjera, besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave, respektit dhe pranimit të mendimeve të ndryshme.

Nga aktivitetet e projektit u evidentua se ndërtimi i një sistemi mbështetës më efektiv, i cili përfshin mësimdhënësit, stafin e shkollës dhe drejtorët, do të mundësonte trajtim më efektiv me sfidat e diversitetit. Përgjegjësia e pamjaftueshme në këtë aspekt reflektohet më së shumti në mënyrën joefikase të komunikimit. Në shumë raste, nxënësit u

ankuan se nuk ishin të informuar mirë për ngjarje të caktuara, aktivitete jashtëshkollore dhe mundësi të tjera, ku mungesa e informacionit nga stafi mësimdhënës u interpretua si “mungesë interesi”. Informacionet zakonisht transmetohen me gojë, gjatë orëve mësimore. Në raste të tjera, nxënësit marrin informacion nga kryetarët e klasave përmes aplikacioneve për komunikim, ndërsa shpesh përmes bisedave në korridore ose me njëri-tjetrin. Nxënësit theksuan nevojën për platforma më të gjera komunikimi ku ata mund të shprehnin në mënyrë të sigurt shqetësimet e tyre, të propozonin iniciativa dhe të shkëmbenin informacione.

Në të ardhmen, zhvillimi i vazhdueshëm i projekteve dhe programeve të tilla është çelësi për promovimin afatgjatë të marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoninë e Veriut. **Të rinjtë kanë potencial të jenë udhëheqës të këtyre ndryshimeve, por mbështetja nga institucionet arsimore, komunitetet lokale dhe shoqëria në tërësi është e nevojshme që ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë.**

Së fundi, edhe pse sfidat janë të mëdha, projekti tregoi se përmes aktiviteteve të përbashkëta, shkëmbimit kulturor dhe bashkëpunimit, të rinjtë në Maqedoninë e Veriut mund të jenë promotorë të një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe më të drejtë. Nuk mund të nënvlerësohet rëndësia e gjithëpërfshirjes në arsim, sepse shkollat janë vendet ku ndërtohen themelet e marrëdhënieve të ardhshme ndëretnike. Me mbështetjen e duhur, të rinjtë mund të kontribuojnë në krijimin e një të ardhmeje në të cilën diversiteti do të jetë burim force dhe jo ndarjeje.

ihr.org.mk

